

Fjalimi i Kryetarit të Bordit Drejtues të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Prof. Dr. Bedri Peci.

Kam kënaqësinë e veçantë që ne emër të Bordit Drejtues të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës t'iu uroj mirëseardhje në këtë event jubilar.

Ndihem tejet i privilegjuar që në këtë ngjarje festive të kem rastin ti drejtohem një audience kaq të respektuar, dhe në retrospektivë, të shkoqis disa nga momentet më të rëndësishme të cilat e kanë shoqëruar BQK-në përgjatë këtij rrugëtimi pesëmbëdhjetë vjeçar.

Megjithëse pesëmbëdhjetë vite përbëjnë një periudhë relativisht e shkurtër kohore, për BQK-në ky hark kohor dëshmon vënien e themeleve të shëndosha mbi të cilat do të ndërtohej dhe zhvillohej i gjithë sistemi financiar i vendit.

Përgjatë gjithë këtyre viteve, puna dhe angazhimi i pa-kompromis i personelit vendor si dhe përkrahja e pa hezituar e partnerëve ndërkombëtar janë sinkronizuar lehtësisht brenda kornizave të përcaktuara nga një vizion i qartë zhvillimi dhe promovimi të vazhdueshëm të sektorit financiar të vendit.

Për pesëmbëdhjetë vite radhazi, ky sektor do vazhdonte të zhvillohej pa lëkundje të mëdha drejt konsolidimit të aktereve në treg dhe harmonizimit të vazhdueshëm të kuadrit ligjorë dhe rregullativ me standardet më të avancuara bashkëkohore të bankingut ndërkombëtar.

Pesëmbëdhjetë vite gjer tani, BQK ushtron funksionin e licencimit, mbikëqyrjes dhe rregullimit të të gjitha institucioneve, të cilat sipas kornizës ligjore kategorizohen si institucione financiare. Paralel me këtë vazhdon edhe zhvillimi i kapaciteteve menaxhuese dhe bartja e përgjegjësiwe profileve profesionale, në administrimin dhe menaxhimin e institucionit. Sfondi profesional i personelit vendor u dëshmuua në shumë sfida përgjate zhvillimit të BQK-se.

Në cilësinë e autoritetit qendror bankar dhe të pagesave, BQK u themelua pikërisht para pesëmbëdhjetë viteve, nën emërtimin “Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës (BPK)”. E gjithë kjo u bë e mundur pas një punë intensive dhe angazhimit të palodhshëm të ekspertëve vendor dhe ndërkombëtar të kohës.

Pas një periudhe tranzitore, në qershor të 2008 hyn në fuqi akti më i lartë juridik i vendit, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e cila, ndër tjera, përcakton edhe mënyrën e rregullimit dhe funksionimit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, si një “institucion i pavarura i cili i përgjigjet vetëm Kuvendit të Republikës së Kosovës”. Në të njëjtën kohë, në qershor 2008, hyn në fuqi edhe Ligji për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, përmes së cilit përcaktohet formati rregullues dhe administrativ i BQK-së. Me këtë pasurohet i gjithë sistemi qeverisës i institucionit në një qasje profesionale dhe gjithëpërfshirëse të të gjithë mekanizmave qeverisës dhe llogaridhënës, duke ruajtur rolin e integruar të licencimit, mbikëqyrjes dhe rregullimit të mbarë sektorit financiar brenda ombrellës së BQK-së.

Momente tjera kyçe në zhvillimin e BQK-së do shënoheshin me jetësimin e projekteve të ndryshme zhvillimore drejt informimit më të drejtë të publikut përmes publikimeve të shumta, të analizave financiare, të ecurive në bilancin e pagesave, pasqyrimin të stabilitetit financiar, funksionit të regjistrimit të kredive dhe vënies në funksion të shërbimeve financiare klientelës me integrimin e pagesave përmes produktit të kos-GIRO.

Në rrafshin ndërkombëtarë BQK do ndërtonte një platformë gjithëpërfshirëse komunikimi dypalësh (bilateral) përmes mekanizmit të “memorandumeve të mirëkuptimit” me autoritetet bankare dhe të mbikëqyrjes e rregullimit të sektorit financiar të vendeve nga ku kishte origjinën kapitali i investuar në Kosovë. Ky format komunikimi dhe bashkërendimi i aktivitetit mbikëqyrës “home-host” u konkretizua me Shqipërinë, Sllovenin, Gjermaninë, Austrinë dhe Turqinë

I gjithë ky sukses ndërtoj një trase të fuqishme e cila bëri të mundshme pastaj anëtarësimin e vendit në institucionet financiare ndërkombëtare, në Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën Botërore dhe në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Zhvillimi i mëtejme profesional i BQK-së u dëshmuar në përshtatshmërinë e ekzekutimit të përgjegjësive të saj karshi “Principeve Themelore të Komitetit të Bazelit për Mbikëqyrje Efektive Bankare”, në raportin përkatës të vlerësimit i cili nxirrte në pah progresin e bërë dhe nënvizonte hapat e mëtejme drejt integritetit të standardeve më të reja të kohës në fushën e bankingut qendror.

Në gjithë këtë kronologji ecjeje përpara, vlerësoj se asnjëherë nuk është e tepërt të theksohet roli kyç i gjitha institucioneve financiare dhe jo-financiare ndërkombëtare që përkrashen zhvillimin e BQK-së, veçanërisht, Zyrën e Thesarit Amerikanë, Fondin Monetarë Ndërkombëtarë, Bankën Botërore, Bankën Qendrore Evropiane, USAID-in, KFW-në, GIZ-in , etj.

Këto institucione bënë të mundur zhvillimin e vazhdueshëm të BQK-së dhe avancimin e agjendës legislative të sektorit financiar, zhvillimin e projekteve të veçanta si; themelimin e tregut të letrave me vlerë, themelimin e fondit të sigurimit të depozitave, hartimin e politikës dhe strategjisë së tregut të banimit, avancimin e infrastrukturës së sistemit të pagesave, ku pas shumë përpjekjeve, u arrit që të sigurohen kodet SWIFT dhe IBAN. Sigurimi i këtyre kodeve lehtësoi ndjeshëm realizimin e pagesave dhe rriti sigurinë e transfereve ndërkombëtare.

E gjithë kjo kronologji zhvillimore është reflektuar në sistemin financiar të vendit me rritje të vazhdueshme të aseteve dhe parametrave tjerë të performancës, duke pasqyruar kështu nivelin e lartë të besueshmërisë publike në këtë sektor.

Është pikërisht tipari i besueshmërisë në tregun financiar, të cilin BQK zotohet ta ruaj dhe ta shtyjë përpara drejt pacenueshmërisë duke promovuar dhe siguruar stabilitet financiar përmes funksioneve të, licencimit, mbikëqyrjes dhe rregullimit të këtij sektori. Sikundër, përmes sigurimit të një sistemi të qëndrueshëm të pagesave, dhe së fundi duke hartuar dhe publikuar analiza ekonomike, financiare dhe të bilancit të pagesave në funksion të informimit sa më të plotë dhe transparent të publikut të gjerë.

Të nderuar pjesëmarrës,

Padyshim që secili nga ne është i vetëdijshëm për sfidat në perspektiven tonë zhvillimore, për të cilat ne kemi zgjedhur orientimin tonë strategjik, të përcaktuara në “planin strategjik 2015-2019”. Brenda mandatit tonë, ne si Bord Drejtues e mbështesim këtë plan dhe angazhohemi fuqishëm në monitorimin e zbatimit të të gjitha orientimeve strategjike dhe zhvillimore.

Bordi Drejtues i Bankës Qendrore beson fuqishëm në qeverisjen e mirë dhe transparente si të pa alternativë drejt funksionimit të pavarur dhe të përgjegjshëm të BQK-së.

Së fundi, më lejoni që ta mbyllë këtë fjalim duke ju përshëndetur të gjithë ju të pranishëm dhe duke i uruar mbarëvajtje kësaj konference jubilarë.

Faleminderit,

Prof. Dr. Bedri Peci

Kryetar i Bordit Drejtues të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës